



**ODA
E FARMACISTËVE
TË KOSOVËS**

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA

RAPORTI I PUNËS DHE AI FINANCIAR 2022 I OFK

Prishtinë

PËRMBAJTJA

1.	ANËTARËSIMI, LICENCIMI DHE RILICENCIMI	3
2.	EDUKIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL.....	4
2.1.	Çmimet për punimet më të mira të anëtarëve tanë për vitin 2021 sipas konkursit të OFK-së	6
2.2.	OFK dhe AKPPM promovojnë Regjistrin e Barnave Nr.6 si dhe Revistën Farmaceutike Nr.2	7
2.3.	PËR VAKSINËN KUNDËR COVID-19 FOL ME FARMACISTËT!.....	8
2.4.	Konferenca Kombëtare e shkencave mjekësore	9
2.5.	Kongresi i farmacisë - E ardhmja e farmacisë në periudhën "post-Covid"	9
2.6.	Ëorkshop Qasja në Inovacion	10
2.7.	KONFERENCËN E VI-TË FARMACEUTIKE “SË BASHKU PËR FARMACEUTIKËN” 11	
2.8.	Oda e Farmacistëve të Kosovës organizoi Tryezë Diskutimi me temën “Legjislacioni në sektorin farmaceutik – Qasja në barna për pacientët”	11
3.	Ceshtjet etike.....	12
3.1.	Prokurori i OFK-së	12
3.2.	Këshilli Etik	13
3.3.	Komisioni etik.....	13
4.	Gjyqi i nderit	13
5.	Ndihma Reciproke dhe Solidariteti.....	13
6.	Këshilli Mbikqyrës.....	13
7.	Provimi i Rilicencimit.....	14
8.	Aktivitet tjera	14
8.1.	"Për Jeten " në përkujtim të profesionistëve shëndetësorë.....	14
8.2.	Raporti i auditorit të jashtëm të OFK-së për periudhën 2019, 2020 dhe 2021	15
9.	KONSTITUIMI I ORGANEVE NGA PËRBËRJA E III-TË E KUVENDIT	15
10.	RAPORTI FINANCIAR PËR VITIN 2022.....	17

1. ANËTARËSIMI, LICENCIMI DHE RILICENCIMI

Ligji për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr. 04/L-150 në kuadër të përgjegjësiv të Odav të Profesionistëve Shëndetësor ka paraparë edhe kompetencën publike të regjistrimit të profesionistëve shëndetësor, licencimit dhe rilicencimit të tyre.

Në këtë vitë, ishte fluks më i madh i kërkesave për rilicencim pasi ishte 5 vjetori i lëshimit të licencave të para nga OFK.

Komisioni i licencimit dhe rilicencimit në periudhën raportuese Janar – Dhjetor 2022,ka shqyrtuar shqyrtuar tematika të ndryshme të përshkruara si në tabelën e mëposhtme

Komisioni për licencim JANAR - DHJETOR 2022



2. EDUKIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL

Odat e Profesionistëve shëndetësor në kuadër të misionit dhe qëllimit për të cilët janë krijuar, një ndër fushëveprimin kryesor kanë procesin e edukimit të vazhdueshëm profesional të farmacistëve si parkusht për rilicencimin e tyre. Puna e KEVP gjate vitit 2022

JANAR – DHJETOR 2022		
Mbledhja		SHQYRTIMET – TEMATIKA
Muaji	Datë	
1/2022	14.01.2022	Shqyrtim i aplikacioneve për valorizim: 16 kandidatë.
2/2022	04.02.2022 16.02.2022	Shqyrtim i aplikacioneve për valorizim: 14 kandidatë. Shqyrtim i aplikacioneve për valorizim: 16 kandidatë.
3/2022	18.03.2022 31.03.2022	Shqyrtim i aplikacioneve për valorizim: 5+1 kandidatë. Akreditimi i projektit OFK _UNICEF
4/2022	14.04.2022 20.04.2022 28.04.2022	Shqyrtim i aplikacioneve për valorizim: 1 kandidatë. Shqyrtim kërkesë për akreditim: 1 kërkesë. Kërkesë për akreditim – OFK. Shqyrtim i aplikacioneve për valorizim: 23 kandidatë
5/2022	24.05.2022 31.05.2022	Shqyrtim i aplikacioneve për valorizim: 18 kandidatë. Shqyrtim i aplikacioneve për valorizim: 5 kandidatë.

6/2022	16.06.2022	Shqyrtim i aplikacioneve për valorizim: 14 kandidatë.
7/2022	15.07.2022	Shqyrtim i aplikacioneve për valorizim: 15 kandidatë. Akreditim i aktivitetit AQH - Kurs
8/2022	18.08.2022 23.08.2022	Shqyrtim i aplikacioneve për valorizim: 14 kandidatë. Shqyrtim i aplikacioneve për valorizim: 18 kandidatë.
9/2022	02.09.2022 08.09.2022 15.09.2022 16.09.2022 27.09.2022	Shqyrtim i aplikacioneve për valorizim: 14 kandidatë Shqyrtim i aplikacioneve për valorizim: 26 kandidatë Shqyrtim i aplikacioneve për valorizim: 16 kandidatë Shqyrtim i aplikacioneve për valorizim: 21 kandidatë Shqyrtim i aplikacioneve për valorizim: 30 kandidatë
10/2022	11.10.2022 19.10.2022 28.10.2022	Shqyrtim i aplikacioneve për valorizim: 51 kandidatë Shqyrtim i aplikacioneve për valorizim: 22 kandidatë Shqyrtim i aplikacionit për akreditim aktiviteti – UBT Shqyrtim i aplikacioneve për valorizim: 75 kandidatë
11/2022	11.11.2022 25.11.2022	Shqyrtim i aplikacioneve për valorizim: 31 kandidatë. Shqyrtim i aplikacioneve për valorizim: 35 kandidatë
12/2022	02.12.2022 16.12.2022	Shqyrtim i aplikacioneve për valorizim: 26 kandidatë Konstituimi i Komisionit Shqyrtim i aplikacioneve për valorizim: 19 kandidatë.

Në kuadër të kësaj kompetencë dhe detyrimi OFK gjatë periudhës së vitit 2022 ka organizuar disa aktivitetet përmes të cilave është realizuar ky process.

2.1. Çmimet për punimet më të mira të anëtarëve tanë për vitin 2021 sipas konkursit të OFK-së

Tashmë është kthyer në traditën e OFK-së, në gjdo fillim viti të ndahet cmimet për punimet më të mirat të anëtarëve për vitin paraprak. Një traditë e tillë ka vazhduar edhe në fillim vitin 2022, ku u ndan cmimet për punimet më të mira të anëtarëve për vitin 2021 sipas konkursit publik. Punimet më të mira u radhitën Kreshnik Hoti, Dardan Hetemi, Eda Mehmeti, Blerina Koshi, Armond Daci, Ermira Krasniqi Boshnjaku, Blerta Pajaziti, Kaltrina Zenuni dhe Jeton Guta. Përkrahjen financiare nga OFK morrën vetëm punimet të cilat nuk kanë përfituar nga konkursi i vitit 2020 si Dardan Hetemi, Blerina Koshi, Armond Daci, Ermira Krasniqi Boshnjaku, Kaltrina Zenuni dhe Jeton Gutaj me pikë të barabartë. Po ashtu në fund të vitit 2022, Keshilli Drejtues ka miratuar edhe komisionin e ri i cili do të mbarvaje konkursin për publikimet gjatë vitit 2022.



2.2. OFK dhe AKPPM promovojnë Regjistrin e Barnave Nr.6 si dhe Revistën Farmaceutike Nr.2

Me 7 Mars u bë promovimi i OFK dhe AKPPM promovojnë Regjistrin e Barnave Nr.6 si dhe Revistën Farmaceutike Nr.2. Në këtë promovim Kryeshefi i AKPPM Z.Arian Ahmeti theksoi se publikimi i Regjistrit të barnave tashmë është traditë dhe pas një pune disa mujore të autorëve ky është numri i gjashtë që nga viti 2010. Në regjistër janë të përshkruara gjithsej 817 lloje të barnave të cilat janë të regjistruara në 3935 forma dhe fortësi të ndryshme. Kryeshefi i AKPPM gjithashtu u zotua se së shpejti do të fillojë puna për digjitalizimin e regjistrit.Në këtë rast zv.Ministri i Shëndetësisë Dr.Arsim Berisha theksoi se rezultatet e tilla janë edhe një shembull i mirë i bashkëveprimit midis Odës së Farmacistëve, Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale dhe profesionistëve nga Fakulteti i Mjekësisë për të përditësuar të rejat sa u përket barnave të regjistruara në Republikën e Kosovës.Kryetari i OFK Prof.Ass.Dr.Arianit Jakupi theksoi se Revista farmaceutike si publikim i OFK tashmë ka edhe numrin e dytë i cili numër vjen me një format dhe rubrika të ngjashme të cilat do të mundohemi ti mbajmë në vazhdimësi. Temat e trajtuara në këtë numër janë të fokusuar në sigurinë e produkteve



medicinale, por trajtimi i temave nga COVID-19 ishte i pashmangshëm, megjithatë i ndërlidhur edhe me temën bosht të këtij

numri.Prodekanja e Fakultetit të Mjekësisë Prof.Ass.Dr.Pranvera Breznica paraqiti biografinë

Prof.Dr.Mentor Disha i cili ishte i përzgjedhur në profilin e farmacistit në këtë numër të revistës me ç’rast OFK i ndau edhe mirënjohje “post mortem”.

2.3. PËR VAKSINËN KUNDËR COVID-19 FOL ME FARMACISTËT!

Oda e Farmacistëve të Kosovës (OFK) së bashku me zyrën e UNICEF dhe në partneritet me USAID Kosova po zhvillojmë një aktivitet profesional në sektorin farmaceutik.

Aktiviteti ka të bëjë me ngritjen e vetëdijësimit lidhur me vaksinimin e popullatës, dhe pasi farmacistët janë në kontakt të drejtpërdrejtë me pacientët, si profesionistë shëndetësorë kanë një mundësi të jashtëzakonshme që të japin këshilla dhe informacione adekuate lidhur me këtë proces.

Kemi realizuar trajnime për farmacistët nga shtatë qendra në Kosovë për mbledhjen e të dhënave, vaksinimin në përgjithësi si dhe komunikimin me pacientët dhe me këtë rast falenderojmë Prof.Illir Begollin për ligjëratat e mbajtura.



2.4. Konferenca Kombëtare e shkencave mjekësore

Oda e Farmacistëve të Kosovës së bashku me Urdhërin e Farmacistëve të Shqipërisë ishin në grupin organizatorë të konferencës kombëtare të shkencave mjekësore



2.5. Kongresi i farmacisë - E ardhmja e farmacisë në periudhën "post-Covid"

Në Maj 2022, Oda e Farmacistëve të Kosovës pas një kohë të gjatë të mungesës së aktiviteteve me prezenc fizik organizoi kongresin e farmacisë E ardhmja e farmacisë në periudhën "post-Covid". Në këtë aktivitet ishin pjesëmarrës mbi 1000 farmacistë nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia.



2.6. Ëorkshop Qasja në Inovacion

Oda e Farmacistëve të Kosovës së bashku me Këshillin e Investitorëve European dhe të përkrahur nga Hoffman La Roche organizuan ëorkshopin “Qasja në inovacion”

- Takimi pati si tema të veçanta:
 - o Marëveshjet për hyrje të menaxhuar (Managed entry agreements)
 - o Zgjidhjet inovative për të përmirësuar qasjen në barna (Innovative solutions to improve access)si dhe
 - o Studimet Klinike për barna (Clinical Trials)



2.7. KONFERENCËN E VI-TË FARMACEUTIKE “SË BASHKU PËR FARMACEUTIKËN”

Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë në bashkëpunim me Odën e Farmacistëve të Kosovës organizon në datat 04, 05, 06 Nëntor 2022, në ambientet e Hotel Tirana International Konferencën e VI-të Farmaceutike me titull “Së Bashku për Farmaceutikën” Konferenca është akredituar për 18 kredi.



2.8. Oda e Farmacistëve të Kosovës organizoi Tryezë Diskutimi me temën “Legjislacioni në sektorin farmaceutik – Qasja në barna për pacientët”.

Rëndësia e përzgjedhjes së kësaj teme ishte pikërisht për shkak të procesit të plotësimit dhe ndryshimit të legjislacionit por me theks të veçantë në qasjen në barna për pacientët. Kjo për shkak të situatës së krijuar me hyrjen në fuqi të Udhëzimit Administrativ 01/2022 por edhe situatës së përgjithshme në sektorin farmaceutik me mungesën e çmimeve të barnave, mungesën e rregullimit të mënyrës së hapjes së barnatoreve sipas kriterëve specifike, profesionale, demografike dhe gjeografike, mungesën e barnave për shkak të mosregjistrimit të tyre etj.

Temat e diskutuara ngjallën debat posaçërisht lidhur me mungesën e barnave e cila mund të rëndohet nëse nuk ndërhyhet me procedura për evidentimin e mungesave dhe gjetjen e alternativave ligjore për importimin e tyre.

Po ashtu si teme tjetër ishte çështja që ka të bëjë me çmimet e barnave pasi që Projekt-Ligji



tashmë është i dorëzuar ka disa muaj në kabinetin e Ministrit dhe pritet diskutimi publik, por që vonesa në finalizimin dhe aprovimin e këtij Ligji po e vazhdon situatën e rëndë të sektorit.

Çështja që ka të bëjë me hapjen e barnatoreve pa asnjë kriter restriktiv ishte tema e tretë e tryezës duke u dhënë edhe

krahasimet me shtetet europiane ku del se Kosova tashmë ka hyrë në top 5 vendet europiane për numrin më të madh të barnatoreve e që në vete është një problematikë e cila e dëmton punën profesionale dhe ofrimin e kujdesit shëndetësor, duke e cënuar rëndë edhe ekzistencën e tyre. Për këtë qëllim u dhanë rekomandimet për të pasur kujdes që në Ligjin e ri të vendoset përcaktimi i pronësisë së barnatores, kriteret restriktive lidhur me distancën në mes të barnatoreve, pastaj shtimin e shërbimeve profesionale që barnatorja mund ti zhvillojë etj.

Në tryezë pjesëmarrës ishin deputetët e kuvendit të Kosovës nga Komisioni për Shëndetësi Z.Shemsedin Dreshaj, Z.Bekim Haxhiu dhe Znj.Floretë Zejnullahu, zvMinistri i Shëndetësisë Z.Arsim Berisha, Sekretari i MSh Z.Naim Bardiqi, Drejtori i AKPPM Z.Sejdë Tolaj, Drejtori i FSSH Z.Bujar Kaçurri, Kryetari i shoqatës së distributorëve Z.Milaim Abdullahu, drejtoresha e barnatores qendrore të QKUK Znj.Shqipe Fetahu, kolegë të tjerë farmacistë nga institucione të ndryshme dhe mediat.

3. Ceshtjet etike

3.1. Prokurori i OFK-së

Në periudhën raportuese nga ana e Prokurorit të OFK-së është mbajtur një seancë, ku e ftuar ka qenë edhe pala ndaj së cilës është ngritur dyshimi i bazuar për falsifikim të certifikatave të edukimit të vazhdueshëm profesional gjatë procesit të rilicencimit në OFK. Deri në fund të vitit nuk është vendosur për procesimin e më tutjeshëm.

3.2. Këshilli Etik

Ndër kompetencat kryesore të cilat ushtrojnë Odat e Profesionistëve Shëndetësor është edhe mbikqyrja profesionale e ushtrimit të profesionit nga ana e anëtarëve. Në kuadër të bashkpunimit me Inspektoriatin Farmaceutik, Këshilli Etik nga raportet e pranuar nga ana e tyre ka konstatuar se në disa raste ka pasur shkelje profesionale nga ana e anëtarëve në raportet e pranuar. Gjatë vitit 2022, Këshilli Etik ka vendosur në 15 raste se ka pasur shkelje profesionale nga ana e profesionistit shëndetësor. Në këtë raport nuk janë të përfshirë masat e shqiptuara nga ana e Këshillit Etik në dhjetor të vitit 2022, për shkak se të njëjtat janë dërguar te anëtarët në vitin 2023, andaj këto masa do të jenë pjesë e raportit për vitin 2023 .

3.3. Komisioni etik

Përbërja e re e zgjedhur nga Kuvendi i III-të i OFK-së ka mbajtur një takim në të cilin ka aprovuar një kërkesë për leje hulumtim profesional përkatësisht shpërndarjen e pytësorit te anëtarit, si formë e ndihmës për anëtarin drejt realizimit të hulumtimit profesiona.

4. Gjyqi i nderit

Gjatë vitit 2022, Gjyqi Nderit ka mbajtur një takim në shqyrtimin e ankeses nr. 14 datë 13.05.2022, në të cilën ka vendosur sipas vendimit nr. 107 datë 14.05.2022.

5. Ndhma Reciproke dhe Solidariteti

Gjatë vitit 2022, Komisioni për Ndhmë Reciproke dhe Solidaritet ka propozuar dy ndihma financiare për anëtarët e OFK-së në shumën prej 1000 Euro si ndihmë ndaj tyre për shkak të gjendejes shëndetësore. Të dy propozimet janë miratuar nga ana e Këshillit Drejtues.

6. Këshilli Mbikqyrës

Nga zgjedhja e përbërjes së re të Kuvendit në muajin Korrik, Këshilli Mbikqyrës ka shqyrtuar raportet mujore të punës për të gjitha organet e OFK-së nga muaji Qërshorë. Në raportet e shqyrtuara këshilli mbikqyrës nuk kishte vërejtje për organet (përgjashtimisht vërejtjeve teknike) dhe kishte një rekomandim për Komision për Licencim dhe EVP për mënyrën e trajtimit të kërkesave për rilicencim gjatë periudhes Shtator – Dhjetor kur ishte edhe fluksi më i madh i licencave (trajtimi në një mbledhje të paktën e të gjitha kërkesave të cilat pranohen gjatë një jave)

7. Provimi i Rilicencimit.

Gjatë vitit 2022, në kuadër të komisionit për provim të rilicencimit të farmacistëve të cilët nuk kanë arritur pikët e mjaftueshme nga aktivitet e edukimit të vazhdueshëm profesional, janë paraqitur 22 kërkesa për t'iu nënshtruar rilicencimit me anë të provimit.

8. Aktivitet tjera

8.1. "Për Jeten " në përkujtim të profesionistëve shëndetësorë

Kryetarët e OPSH-ve në shenjë mirënjohje e përkujtimi të sakrificës së profesionistëve shëndetësor vendosëm që data 16 shkurt të shpallet si ditë përkujtimore e profesionistëve shëndetësor në Republikën e Kosovës.

Po ashtu gjatë ditës së bashku me Ministrin e Shëndetësisë Dr. Latifi, Kryetarin e Prishtinës z. Rama dhe Kryetarët e Odave të Profesionistëve Shëndetësorë, u bë përrurimi i memorialit/obeliskut si shenjë përkujtimit të kontributit dhe sakrificës të të gjithë profesionistëve shëndetësorë të Republikës së Kosovës.

Në këtë datë të shënuar shpreh falënderimin dhe mirënjohjen e përzemërt për të gjithë farmacistët të cilët gjatë gjithë këtyre periudhave kanë dhënë kontributin e tyre profesional dhe human në shërbim të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Obelisku është realisuar falë bashkëpunimit të OPSH-ve dhe donatorëve që kanë përkrahur dhe kontribuar për këtë monument.



8.2. Raporti i auditorit të jashtëm të OFK-së për periudhen 2019, 2020 dhe 2021

Oda e Farmacistëve të Kosovës, ka pranuar raportin e jashtëm financiare e funksional të



auditorit me të cilin është konfirmuar se në këtë periudhë (2019, 2020, 2021) OFK ka zgjidhur të gjitha vërejtjet e dhëna në raportin paraprak për vitin 2016, 2017, 2018.

Raporti si i tillë është i pakualifikuar i cili njëkohësisht paraqet vlerësimin më të lartë për një institucion.

Raporti vlerëson se janë adresuar të gjitha gjetjet e raportit paraprak.

9. KONSTITUIMI I ORGANEVE NGA PËRBËRJA E III-TË E KUVENDIT

Gjatë Qërshorit 2022, OFK ka konstituuar përbërjen e Kuvendit të ri të legjislaturës së III-të, në të cilin u zgjodh edhe Kryetari i saj.

OFK në kuvendin zgjedhor me 12 korrik për organet drejtuese ka zgjedhur përbërjen e Këshillin Drejtues, Këshillin Mbikëqyrës, Këshillin Etik, Gjyqin e Nderit dhe Prokurorin e OFK, me ç'rast në takimin e mbajtur u zgjodhën edhe dy zv.kryetarët e saj.

Me propozim të kryetarit të OFK zv.kryetarë të OFK u zgjodhën Dren Qerimi dhe Nita Kelmendi Hysa.

Anëtarë në Këshillin Drejtues u zgjodhën Fatos Aliu, Ismajl Shurdhaj, Jeton Gutaj, Shefqet Mehmetukaj dhe Visar Ademi.

Në Këshillin Mbikëqyrës u zgjodhën: Astrit Iljazi - kryetar, Driton Gashi - zv.kryetar kurse anëtarë Jehona Zogaj dhe Suada Halimi.

Në Këshillin Etik u zgjodhën: Sultane Havolli – kryetare, Gazmend Demiri - zv.kryetar kurse anëtarë Adelina Surdulli dhe Teuta Balidemaj.

Në Gjyqin e Nderit u zgjodhën Demush Bajraktari - kryetar, Besnik Basholli - zv kryetar kurse anëtarë Shkurtesa Berisha dhe Zgjim Balaj si dhe

Prokuror i OFK u zgjodh Alban Bakolli.

Po ashtu, në dhjetor u bë edhe plotësimi i organeve, ku anëtare e Këshillit Mbikëqyrës u zgjodh znj. Teuta Rexhepi ndërsa anëtar i Gjyqit të Nderit z. Ismail Halili.

Po në takimin e dhjetorit, Kuvendi i OFK-së zgjodhi edhe përbërjen e komisioneve të përherëshme dhe të përkohshme për mandatin e III-të të Kuvendit.



10. RAPORTI FINANCIAR PËR VITIN 2022

RAPORTI FINANCIAR

PËR PERIUDHËN JANAR_DHJETOR 2022

TE HYRAT	Realizimi ne €
Të hyrat nga MSH të përcaktuara me Statut dhe Ligj	
Të hyrat nga MSH-ja te arketuara pas 3 vjeqarit të themelimit të Odës	
te hyrat nga Aantaresia	81,779.00
Te hyrat nga Licencimi	11,410.00
Te hyrat nga Rilicencimi	52,300.00
Te hyrat nga mbajta e provimit te rilicencimit	5,500.00
Te hyrat nga pagesa e vertetimit te Kodit Etike	195.00
Te hyrat nga pjsmarrja ne konferenca vendore	54,850.00
Te hyrate nga pjsmarrja ne seminare dhe gala mbramje	1,160.00
Te hyrat nga dhenja e faksimilit	580.00
Te hyrat nga akreditimi	800.00
Te ardhurat nga sponzorimet	39,500.00
Te hyrat per vonese te pagese se takses administra	365.00
Te hyrat nga ndeshkimet	1,000.00
Te hyrat nga donacionet	8,864.00
Te hyra te tjera	-
TE HYRAT NE TOTAL	258,303.00
SHPENZIMET (Pagat bruto dhe KPP)	Realizimi ne €
Pagat bruto, shpenzimet per meditje per kuvend dhe keshilla dhe komisione (është i perfshirë tatimi mbi pagë)	111,530.55
Kontributet Pensionale të Punëdhënësit	5,541.63
TOTALI I SHPENZIMEVE PER PAGA MEDITJE PER KUVEND , KESHILLA DHE KOMISIONE	117,072.18
SHPENZIMET TJERA OPERACIONALE	
Shpenzimet e zyres	16,209.05
Shpenzimet e printimit te banerave , ID, revistave etj	9,426.78
Shpenzimet e ujit te pijes	203.30
Shpenzimet e internetit	315.30
Shpenzime per Google Suite	62.39
Shpenzimet e telefonit	95.42
Shpenzimet per SMS	519.20
Shpenzimet e marrjs se veture me qira	270.00
Shpenzimet juridike dhe te auditimit	3,200.01
Shpenzimet per softwer	590.00
Shpenzimet e derivateve	1,551.30
Shpenzimet per foto ne evente dhe konferenca	1,663.00
Shpenzimet per organizimin e konferencave	39,020.00
Shpenzimet per mbajtjen e konferencave	1,250.00

Shpenzimet e perkthimit	525.00
Shpenzimet e provizioneve bankare	933.40
Shpenzimet e reklames	2,655.00
Shpenzimet e reprezentacionit	642.27
Shpenzimet per mirëmbajtje te WEB-it	1,770.00
Shpenzimet e udhetimit jasht vendit	2,625.18
Shpenzimet e akomodimit	5,596.05
Shpenzimet e udhetimit - transporti local	158.90
Shpenzimet e ushqimit	3,012.30
Shpenzimet e solidaritetit	2,000.00
Shpenimet tjera	-
TOTALI I SHPENZIMEVE OPERACIONALE	94,293.85
PERMBLEDHJA	
SALDO ME 31.12.2021	40,543.42
TE HYRAT	258,303.00
TE HYRAT E SHTYERA	33,008.71
GJITHESEJT TE HYRAT	265,837.71
GJITHESEJT SHPENZIMET	211,366.03
SALDO ME 31.12.2022	54,471.68